

Pasi të vaksinohem, pse duhet të vazhdoj të respektoj gjestet pengesë të përhapjes së virusit?

Ne duhet të jemi ende të kujdesshëm për ca kohë duke respektuar të gjitha masat paraprake të dobishme siç janë: (mbajtja e maskës, distanca fizike, higjiena e duarve, ajrimi i dhomave për shembull) për arsye të ndryshme:

- ▶ vakcina nuk ju mbron menjëherë pas administrimit;
- ▶ popullsia vaksinohet gradualisht, ne nuk jemi të gjithë të vaksinuar në të njëjtën kohë;
- ▶ është e vështirë të vlerësohet deri në çfarë mase edhe të vaksinuar, një bartës pa simptoma mund të infekttojë akoma persona të tjerë.

#jemevaccine



Për të ditur më shumë

Faqja e internetit jemevaccine.be ju drejton lidhur me informacionet përkatëse dhe ato të vlefshme nga ana shkencore. Aty do të gjeni edhe lidhje të dobishme për mbështetjen e komunikimit.

Për çdo pyetje, do t'ju dëgjojmë në **0800/45 019**

Redaktori përgjigjës : J. Riguelle| Rue de la Rivelaïne 21, B-6061 Charleroi | Mars 2021 | Numri i deponimit ligjor

Pyetësi shëndetësor

Mbiemri : Emri :
Data e lindjes :/..../...
Numri i regjistrimit kombëtar :

Pasi të merrni këtë dokument, kontaktoni mjekun tuaj para se të shkoni në qendrën e vaksinimit, NËSE:

- ▶ Keni pasur një reaksion alergjik të rëndë ose keni pasur nevojë për kujdesje urgjente pas vaksinimit ose në rrethana të tjera.
- ▶ Vuani aktualisht nga një **infeksion akut**.
- ▶ Gjatë 14 ditëve të fundit, ju keni rezultuar me një test COVID pozitiv, nëse keni apo jo simptoma.
- ▶ Jeni shtatzënë ose dëshironi të keni një fëmijë 2 muaj pas vaksinimit. Ushqyerja me gji nuk kërkon shtyrjen e vaksinimit.

Mjeku juaj mund të vendosë nëse duhet të shtyhet apo jo vaksinimi ose nëse duhet të merrni masa paraprake të veçanta.

Pyetësi shëndetësor duhet të paraqitet në sportelin e pritjes të qendrës së vaksinimit për anamnezën tuaj (gjendja shëndetësore). Për të mbrojtur të dhënat tuaja personale, ju lutemi ta merrni përsëri këtë dokument me vete.

	PO/OUI	JO/NON
Keni paraqitur deri tani një reaksion alergjik të rëndë?		
Keni kaluar Covid-in ose keni rezultuar me një test Covid pozitiv këto 14 ditët e fundit ?		
Keni temperaturë ose jeni i (e) sëmurë?		
Jeni shtatzënë ose keni ndonjë projekt për të qenë shtatzënë?		
A merrni ju ilaçe kundër mpiksjes se gjakut ?		



COVID-19 Unë vaksinohem!

INFORMACIONE dhe PYETËSORI I SHËNDETËSOR për qytetarët





A do të vaksinohem

**Ndërkohë që strategjia e vaksinimit po përparon, vak-
sina ju propozohet sot qytetarëve.**

Qëllimi është që të paktën 70% e popullsisë të vaksi-
nohet për të siguruar imunitetin kolektiv.

Vaksinimi është i lirë dhe me dëshirë. Vendimi për t'u
vaksinuar përbën një gjest të fortë në favor të popull-
sisë dhe të Shëndetit publik.

**Ju do të gjeni në anën e pasme të kësaj faqeje një py-
etësor shëndetësor i cili duhet plotësuar para vaksi-
nit dhe nëse është e nevojshme me mjekun tuaj famil-
jar. Merrni këtë pyetësor me vete ditën e vaksinimit.**



Vaksinat janë të disponueshme në Belgjikë

Belgjika merr lloje të ndryshme vaksinash në momente
të ndryshme të fushatës së vaksinimit.

Les vaccins Pfizer/BioNTech et Moderna sont des
vaccins à ARN messenger.

Vaksinat Pfizer/BioNTech, Moderna dhe CureVac janë
vaksina të ARN mesazher.



Vaksinat e ARN mesazher (mRNA)

Këto vakcina janë të përbëra nga një molekulë që
quhet ARN mesazher e cila përmban informacionet në
mënyrë që vetë trupi ynë të prodhojë lëndë kalimtare
anti-gjene. Anti-gjeni do të provokojë atëherë një
përgjigje imune dhe do të prodhojë antitropa që
synojnë shkatërrimin e virusit.



Vaksinat e transportuesit viral (Adénovirus)

Bëhet fjalë për vaksinat që përmbajnë një virus të pa-
dëmshëm por të afta për të prodhuar një antigen të
njëjtë me atë të koronavirusit dhe të shkaktojë kësh-
tu një përgjigje imune. Kështu, antitruapat e formuar
mund të sulmojnë virusin e Covid-19.



Vaksinat kundër COVID-19 janë të efektshme?

Shumë studime nënvizojnë efektin e vaksinës kundër
COVID-19 edhe nëse bëhet fjalë për vaksinat e
ARN-së ose të transportuesit viral.

Ky efikasitet mund shihet si më poshtë vijon: pakësi-
mi i numrit të infektiveve, nga ashpërsia e sëmundjes,
rreziku i shtrimit në spital dhe vdekshmëria lidhur me
koronavirusin.

Ju mund të gjeni edhe më shumë detaje në faqen
e internetit të Agjencisë federale të ilaçeve dhe
produkteve shëndetësore (www.afmps.be) gjithashtu
edhe mendimet e Këshillit të lartë për Shëndetin
([https://www.health.belgium.be/fr/conseil-superieur-
de-la-sante](https://www.health.belgium.be/fr/conseil-superieur-de-la-sante)).



Vaksinat kundër COVID-19 janë të sigurta?

CSi për të gjitha vaksinat, Agjencia evropiane e
ilaceve (EMA) dhe Agjencia frankofone e ilaceve dhe
produkteve shëndetësore (AFMPS) kontrollojnë me
përpikmëri të gjitha të dhënat lidhur me vaksinat
kundër COVID19.

**Efektet e padëshirueshme të menjëhershme
janë të padëmshme dhe klasike** pas vaksinës
:temperaturë, dhimbje koke dhe lodhje. Si për

të gjitha ilaçet rreziku i goditjes alergjike ekziston por
është jashtëzakonisht i rrallë. Kjo është arsyeja që ne
vëzhgojmë 15 minuta (30 nëse ka alergji serioze të
mëparshme) pas injeksionit.

AFMPS publikon çdo javë **një përmbledhje të
gjithanshme të efekteve të padëshirueshme të
sinjalizuara** pas bërjes së vaksinës COVID-19 në
Belgjikë: www.afmps.be



A jam i (e) detyruar të vaksinohem ?

Vaksinimi është një **veprim me dëshirë**. Nuk ekziston
një detyrim profesional ose tjetër.

Puna e rëndësishme e kryer lidhur me informacionin
dhe ndërgjegjësimin synon t'i mundësojë secilit bër-
jen e një zgjedhjeje të informuar. Kjo është arsyeja
për të cilën ne bëjmë gjithçka për t'ju sjellë përgjig-
jet e nevojshme për pyetjet tuaja legjitime.

Vaksina është **falas**.



je me vaccine.be

**Siguria është një nga kushtet e
autorizimit të vënies në treg të
vaksinës; vaksinat kundër COVID-19
plotësojnë të njëjtat kërkesa cilësore
si çdo vaksinë tjetër.**